



25.07.2014

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT

**Reagim ndaj shkrimit të botuar në “Veçernje Novosti”, me titullin: Otimaju
“Lolinu” fabriku**

Prishtinë - Agjencia Kosovare e Privatizimit reagon ndaj shkrimit të botuar në median e juaj me datë 23 korrik 2014 me titull: Otimaju “Lolinu” fabriku, ndërsa kërkon që në rastet kur shkruhet për Agjencinë dhe për privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore të Kosovës të kontaktohet Agjencia, që është institucioni i vetëm që ka kompetenca për të administruar me ndërmarrjet shoqërore të Kosovës, pa marrë parasysh a gjenden në territorin e Kosovës apo jashtë saj.

Agjencia Kosovare e Privatizimit sqaron se ka ekskluzivitetin e privatizimit të pronës shoqërore në territorin e Kosovës, dhe ky mandat buron nga Kushtetuta e Kosovës dhe nga Kuvendi i Kosovës, përmes Ligjit të AKP-së të miratuar po nga ky Kuvend. AKP e zhvillon procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe asetet e tyre sipas Ligjit të saj në gjithë territorin e Kosovës dhe përveç pesë zyreve të saja regjionale (në Prishtinë, Gjilan, Prizren, Pejë dhe Mitrovicë), ka të hapura dhe janë funksionale zyre satelitore edhe në vendbanime me shumicë serbë në Shtërpce, Leposaviç e Graçanicë.

Agjencia edhe në të kaluarën ka privatizuar, edhe aktualisht po privatizon ndërmarrje dhe asete të tyre edhe në vendbanime me shumicë serbë, si dhe ka gjithnjë e në numër më të madh ofertues serbë që po marrin pjesë në procesin e privatizimit.

Pra, në tenderët që i zhvillon AKP marrin pjesë blerës nga të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë, përfshirë edhe komunitetin serbë dhe këtë të drejtë të pjesëmarrjes në tenderët për shitjen e ndërmarrjeve dhe asetëve të tyre e ka të garantuar çdo ofertues që dëshiron të jetë pjesëmarrës në proceset tenderues të AKP-së dhe që i plotëson kriteret e paracaktuara me Ligj e akte nënligjore.

Ju rikujtojmë se edhe në Bordin e Drejtorëve të AKP-së, organ ky vendim marrës për proceset që zhvillon AKP, është përfaqësuar komuniteti serbë, ashtu siç përcaktohet me Ligjin e AKP-së për përfaqësimin e komunitetit joshqiptar në këtë Bord.

Edhe përsa i përket shpërndarjes së shumës 20 % për punëtorët nga shitja e ndërmarrjeve shoqërore, procesi është i dizajnuar për të pamundësuar diskriminimin. Punëtorët e komunitetit



serbë të angazhuar nëpër ndërmarrje shoqërore përfitojnë nga pjesa e 20 % e shitjes së aseteve sipas Rregulloreve të UNMIK-ut.

Pra, Agjencia ushtron funksionet bazuar në Kushtetutën dhe në Ligjet në fuqi dhe mandatin e vet ligjor do ta ushtroj në gjithë territorin e Kosovës. Ndërkaq palët e pakënaqura që mund të kenë pretendime pronësore ndaj ndonjë aseti apo ndërmarrjeje, duhet të drejtohen në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, e cila ka juridiksion mbi AKP dhe vendimet e saj janë të obligueshme për Agjencinë.

FUND